



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 173, Datë 29.08.2024**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR  
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STAVEC”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1765/2 prot., datë 28.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Stavec”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 04.11.2020, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1765 prot., datë 15.08.2024 dhe nr. 1765/1 prot., datë 19.08.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për modifikimin e licencës, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec”, nga 6,520 MW në 8,46 MW.
- Pavarësisht se kërkesa e shoqërisë për modifikimin e licencës është bërë për kapacitetin 8.46 MW, në Raportin e Oponencës Teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) përcaktohet se sipas projektit të zbatimit të ndryshuar, kapaciteti i HEC “Stavec”, do të jetë 8440 kW.

- Rritja e kapacitetit të kërkuar, tejkalon kufirin e përcaktuar në pikën 2.3 të Licencës për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike, e cila parashikon se: *Çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në Aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj Liçence*, ndaj kërkesa e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. i nënshtrohet vendimmarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A, të Rregullores dhe po ashtu rezulton që shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.
- Rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE “Raportin e Oponencës Teknike” të AKBN-së, dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 1408/2 prot., datë 15.05.2023, ku përcaktohet se sipas projektit të zbatimit të ndryshuar kapaciteti i HEC “Stavec”, do të jetë 8440 kW, por dokumentacioni tjetër i aplikimit për modifikimin e licencës nuk rezulton të jetë i përditësuar nga sa është depozituar më parë për qëllime të pajisjes me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, pasi konkretisht duhet të depozitohet:
  - Qëndrimi i MIE-s (miratimi i raportit të oponencës teknike të AKBN-së për projektin e zbatimit të ndryshuar të HEC “Stavec” apo kontrata shtesë e koncesionit ku të reflektohen ndryshimet përkatëse);
  - Qëndrimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) (në rast se Leja mjedisore me nr. 289/11 prot., datë 10.07.2013, është e vlefshme dhe për projektin e ri të zbatimit të HEC “Stavec”, apo shoqëria duhet të pajiset me leje të re);
  - Qëndrimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) (në rast se Leja për përdorimin e burimit ujor, me nr. 27 prot., datë 07.11.2022, vlen dhe për shtimin e fuqisë së HEC “Stavec” apo shoqëria duhet të pajisjet me leje të re);
  - Qëndrimi/miratimi i operatorit të rrjetit për shtimin e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec” në 8.44 MW.
- Për sa më sipër vlerësohet që këto dokumente të sqarohen me shoqërinë pas fillimit të procedurës, ndërkohë që ERE do t’i drejtohet edhe vetë këtyre insitucioneve/organeve për qëndrimin e tyre sipas kompetencave përkatëse në lidhje me këtë ndryshim të projektit të zbatimit dhe të kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 04.11.2020, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “STAVEC” nga 6,520 MW në 8,44 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**